



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 4713 prot.

Himarë, më 26.06.2026

URDHËR

Nr. 339 Datë 26.06/2026

PËR

“DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMEVE GJATË SEZONIT TURISTIK”

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin 8378/1998 “Kodi rrugor i Republikë së Shqipërisë”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM-së Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, Udhëzimit të përbashkët Nr.7967/2018 “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin e mallrave përgjatë sezonit turistik” dhe VKB Himarë Nr.15 datë 28.04.2026 “ Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës”. Me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar ndotjet dhe zhurmat që vijnë si rezultat i ndërtimeve:

URDHËROJ:

- 1- Pezullimin e përkohshëm të punimeve, të subjekteve që janë pajisur me leje ndërtimi në zonën turistike të Bashkisë Himarë, për periudhën 27.06.2026-15.09.2026.
- 2- Periudha e pezullimit të punimeve parashikuar në pikën 1 të këtij urdhri, do t’i shtohet si afat periudhës së përfundimit të punimeve miratuar nga Bashkia Himarë.
- 3- Subjektet ndërtuese të marrin masa për rrethimin, veshjen e objektit ku po punohet me materiale estetike, për të krijuar mjedis miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj.
- 4- Subjektet ndërtuese/zbatuese që po kryejnë ndërhyrje në përmirësimin e rrjeteve të komunikimit, linjave të ujësjellësit, ndërtimit të rrugëve, të kthejnë ambjentet në gjendjen e mëparshme brenda datës 30/06/2026.
- 5- Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Himarë, Policia Bashkiake Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Himarë.
Ky urdhër hyn në fuqi më 27/06/2026.

KRYETARI
Vangjel Tavo

